



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës: 14.07.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “Albo Group” SH.P.K përfaqësuar nga Shpend Sopa lidhur me aktivitetin e prokurimit nr. 613-22-6619-2-2-1 për “Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal” Autoriteti Kontraktues nxjerr:

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim Albo Group” SH.P.K përfaqësuar nga Shpend Sopa lidhur me aktivitetin e prokurimit nr. 613-22-6619-2-2-1 për “Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal”

Vërtetohet Njoftimi për kontratë i bërë më datën 04.07.2022, të publikuara në platformën e prokurimit.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Albo Group” SH.P.K Parashtruesi i Kërkesës për Rishqyrtimin e kushteve të tenderit për aktivitetin e prokurimit “Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal, nuk ka ofruar asnjë mbështetje ligjore për pretendimet e tija se kriteret e përcaktuara për dhënien e kontratës janë diskriminuese dhe në kundërstim me legjislacionin në fuqi.

Pretendimi i parashtruesit të kërkesës se Autoriteti kontraktues (AK) ka bërë shkeljen e nenit 1 të LPP nuk ka asnjë mbështetje ligjore. Komuna e Lipjanit si AK e ka publikuar tenderin për dhënien e kontratës në mënyrë transparente dhe me këtë rast është duke kërkuar operator të kualifikuar dhe kompetent për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) si një nga dokumentet themelore strategjike dhe multisektoriale për zhvillimin e ardhshëm së paku tetë (8) vjeçar të Komunës. Ky qëllim arrihet vetëm përmes ofrimit të

shërbimeve profesionale nga një operator i përgjegjshëm dhe që ka kapacitete profesionale dhe përvojë në hartimin e këtyre dokumenteve strategjike.

Pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 7 të LPP nuk është aspak e bazuar. Kërkesa e përcaktuar në dosjen e tenderit që ofertuesit të ofrojnë dëshmi/ kontrata për kryerjen e punëve të ngjajshme ka mbështetje të plotë ligjore dhe kjo për AK ofron një siguri për realizimin e plotë të qëllimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht për realizimin e projektit sipas kërkesave ligjore dhe nevojave reale të Komunës. AK ka të drejtë të kërkojë të dhëna nga operatorët ekonomik për të dëshmuar kapacitetet e tyre profesionale teknike. Prandaj ky kusht i përcaktuar ka mbështetje të plotë në nenin 68 të LPP-së..

PZHK si një nga dokumentet themelore strategjike dhe multisektoriale mund të jetë përmbajtësor dhe objektiv vetëm me njohjen e plotë të terrenit të komunës dhe të gjitha të dhënave të tjera, të cilat shërbejnë si bazë informacioni për analizimin e gjendjes dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme. Një pajisje e kërkuar elektronike që do të mundëson matjen e saktë të hapësirave të ndryshme dhe përcjelljen e të dhënave në bazë të zonimit të hapësirës, shfrytëzimit të saj, gjendjes faktike të terrenit etj. është e domosdoshme për të ofruar informacion të plotë, objektiv dhe të shpejtë – mbi bazën e të cilave pastaj bëhen vlerësimet e gjendjes dhe përcaktohen prioritetet strategjike. Kjo kërkesë e përcaktuar në dosjen e tenderit ka mbështetje të plotë në nenin 69 të LPP-së. Për më shumë AK në dosjen e tenderit ka mundësuar që kjo pajisje mund të merret edhe në shfrytëzim nga operatori ekonomik.

Pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 59 të LPP, po ashtu nuk qendron dhe nuk është e faktuar. Për më shumë kjo dispozitë ka të bëjë me Ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve dhe nuk ndërlidhet aspak me pretendimet e parashtruesit të Kërkesës për Rishqyrtim.

Pretendimi i parashtruesit të kërkesës në shkeljen e nenit 60 të LPP nuk paraqet asgjë kontestuese. Autoriteti kontraktues ka përcaktuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm. Secili kriter është relevant për qëllimin e aktivitetit të prokurimit, i matshëm dhe për secilin prej tyre është përcaktuar pesha e vlerësimit.

Gjithnjë duke pasur parasysh rëndësinë dhe peshën e një dokumenti strategjik zhvillimor dhe punën e vazhdueshme të operatorit fitues me AK, palët tjera të interesit, duke përfshirë edhe zhvillimin e shqyrtimeve publike, atëherë menaxheri i operatorit ekonomik duhet të ketë një përvojë profesionale të domosdoshme në menaxhimin e këtyre projekteve. Prandaj kriteret e përcaktuara janë në përputhje të plotë me nenin 52.3 dhe 60 të LPP.

Duke i pasur parasysh dispozitat e lartëshënuara, kriteret e vendosura nuk janë diskriminuese, por thjesht janë ekuivalente me nevojat e hartimit të një dokumenti strategjik të rëndësisë së veçantë.


AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtör i Prokurimit